REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË

Nr. 2397 Regj.Them.
Datë 05.02.2026 Regj. **Datë vendimi 23.09.2026**

V E N D I M

"PËR PUSHIMIN E ÇËSHTJES"

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e përbërë nga:

GJYQTARE: Oltjona GOXHA

Me sekretare gjyqësore **Silvi Xhakolli** në Tiranë, sot më **datë 23.09.2026**, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura, kërkesën penale me Nr.2397 Regj.Them., datë e ardhjes së dosjes pranë gjyqtares **06.02.2026** që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykata se Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, përfaqësuar nga **prokurorja Esmeralda Keshi (jo prezent).**

PERSON NËN HETIM: **Ulian Barjami,** identifikuar me letërnjoftim Nr. Personal I 80320081 F, i biri i Esat dhe i Dhurata, i dtl. 20.03.1988, lindur në Gjirokastër dhe banues në Tiranë, Rezidenca "Park Life" Farkë, me shtetësi shqiptare, me gjëndje civile beqar, me 1 fëmijë, me arsim të lartë, me gjëndje gjyqësore i padënuar, mbrojtur nga **av.Brajan Cekodhima** (i zgjedhur).

OBJEKTI: Pushimi i procedimit penal nr.7882 viti 2025, për veprat penale *"Kanosja për shkak të detyrës", "Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit"* dhe *"Kanosja e gjyqtarit",* parashikuar nga nenet 238/3, 316 dhe 317 Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Neni 328/1 shkronja "dh" dhe 329/a të K.Pr.Penale.

VIKTIMA: **Gjergji Ceka,** i biri i Taulant dhe i Pranvera, i dtl.20.11.1991, lindur dhe banues në Elbasan, me shtetësi shqiptare, me arsim

të lartë, me gjendje gjyqësore i padënuar (në mungesë me dijeni).

Në përfundim të seancës paraprake të zhvilluar në mungesë të përfaqësuesit të Prokurorisë, në prani të personit nën hetim dhe mbrojtësit të zgjedhur, si dhe në mungesë të viktimës Gjergji Ceka me dijeni rregullisht Gjykata, pasi shqyrtoi në tërësi përmbajtjen e kërkesës së organit të akuzës dhe provave bashkëlidhur saj;

VËREN:

I. Procedura.

1. Pranë kësaj gjykate është paraqitur kërkesa penale me objekt: *"Pushimin e procedimit penal nr.7882/2025, për veprat penale "Kanosja për shkak të detyrës", "Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit" dhe "Kanosja e gjyqtarit", parashikuar nga nenet 238/3, 316 dhe 317 Kodit Penal".*

2. Përpara shqyrtimit në thelb të kërkesës, Gjykata mori në shqyrtim kryesisht çështjen e juridiksionit dhe të kompetencës lëndore e tokësore. Bazuar në nenet 69, 13/2, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale Gjykata konstatoi se çështja hynë në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të saj.

3. Gjykata pasi mori fizikisht dosjen më datë 26.06.2024, brenda afatit ligjor të sanksionuar në K.Pr.Penale, konkretisht nenet 329/a, dhe 329/b caktoi seancën gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës dhe urdhëroi sekretarinë gjyqësore për njoftimin e prokurorisë, personit nën hetim, dhe viktimës duke ju lënë në dispozicion dhe afatin e nevojshëm për të paraqitur memorie ose dokumente, për tu njohur me akte etj.

4. Gjykata në zbatim të nenit 58 dhe 329/b/2 te K.Pr.Penale vijoi gjykimin pa pjesëmarrjen e prokurores si dhe pa pjesëmarrjen viktimës, në kushtet kur kishin dijeni rregullisht për datën dhe orën e seancës dhe nuk u paraqitën pa asnjë shkak legjitim, pasi në një rast të tillë ligji nuk parashikon zhvillimin e seancës me pjesëmarrjen e detyreshme të tyre[1].

II. Faktet dhe provat.

5. Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se, Prokuroria pranë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr.7882/2025, për veprat penale *"Kanosja për shkak të detyrës", "Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit" dhe "Kanosja e gjyqtarit", parashikuar nga nenet 238/3, 316 dhe 317 Kodit Penal".*

[1] Shih vendimin njësues nr. 00- 2025 -1007 (82), datë 27.03.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

6. **Nga hetimet kryera në funksion të këtij procedimi penal ka rezultuar se:** Më datë 22.10.2025 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr.7882, për veprat penale të "*Kanosjes për shkak të detyrës*", "*Kundërshtimit dhe goditjes së gjyqtarit*" dhe "*Kanosjes së gjyqtarit*" parashikuar nga nenet 238/3, 316 dhe 317 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Ulian Barjami, mbi bazën e materialit të përcjellë me shkresën nr.1102, datë 21.10.2025, për kompetencë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan. Nga aktet rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr.1222, datë 20.10.2025, mbi bazën e kallëzimit penal nr.1888, datë 20.10.2025, për veprat penale "*Kanosja për shkak të detyrës*", "*Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit*" dhe "*Kanosja e gjyqtarit*" parashikuar nga nenet 238/3, 316 dhe 317 të Kodit Penal.

7. Nga hetimi ka rezultuar se më datë 17.10.2025, punonjësit e policisë të planifikuar me shërbim në Sallën Nr.1, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, kanë njoftuar, se gjatë seancës gjyqësore për "*Vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masave te sigurisë ndaj 14 (katërmbëdhjetë) personave të arrestuar me date 13.10.2025*", avokati i njërit prej personave të arrestuar, konkretisht Av. Ulian Barjami, mbrojtës i shtetasit Maksim Suçi, gjatë relatimit të mbrojtjes së klientit të tij është shprehur se do të merrej personalisht me prokurorin e çështjes dhe punonjësit e policisë gjyqësore që kishin kryer veprime në lidhje me çështjen.

8. Menjëherë, pas marrjes së këtij informacioni nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan janë organizuar shërbimet dhe janë kryer veprimet hetimore përkatëse.

9. Fillimisht, është administruar nëpërmjet procesverbalit të sekuestrimit, një DVD/R/"MediaRange" 4.7 GB, me mbishkrim "17.10.2025 SALLA I", ku ndodhej regjistrimi audio i seancës gjyqësore të zhvilluar më datë 17.10.2025, në Sallën Nr. 1, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

10. Në momentin e hapjes së materialeve të administruara në DVD/R, është konstatuar se në të ndodhen 3 (tre) "file" audio, me emërtim si më poshtë: 1. Salla1 20251017-1134 01dc3f5a0ad797ao: 2. Salla1 20251017-1432 01dc3f72e4686220; 3. Salla1 20251017-1446 01dc3f74acfa44dc0.

11. Nga procesverbali përkatës ka rezultuar se nga dëgjimi i regjistrimit audio të mësipërm dhe përkatësisht në "file"-in me emërtim "*Salla 1 20251017-1134_01dc3f5a0ad797a0*"[2], paraqitet me interes për hetimin, biseda e zhvilluar në seancën gjyqësore, ku dallohet komunikimi ndërmjet Gjyqtarit Megi Strakosha, Prokurorit Gjergji Ceka, personit nën hetim Maksim Suçi dhe mbrojtësit të tij, avokatit Ulian Barjami.

12. Biseda ndërmjet personave të sipërcituar paraqitet si më poshtë:

---

[2] Pjesa e parë e seancës, që përfshin momentin e fillimit deri në pushimin e parë prej 10 minutash të caktuar nga Gjyqtari.

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Vijojmë me Maksim Suçi.*

***Avokat Ulian Barjami**: Faleminderit zonja Kryetare! Zonja Kryetare, paraprakisht kemi nevojë për një sqarim nga....*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Avokati Ulian Barjami.*

***Avokat Ulian Barjami**: nga Prokurori. Konstatojmë se asnjë nga aktet e Prokurorit nuk përputhen me njëra-tjetrën. Pra kemi verbalin e arrestimit të flagrancë të shtetasit Maksim Haxhia, ku thuhet, ku në momentin e ndërhyrjes së shërbimeve të policisë...*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Të kujt? Shtetasit Maksim...?*

***Avokat Ulian Barjami**: Maksim Suçi, me fal. Më fal, Maksim Suçi, na është bërë mendja Haxhia. Maksim Suçi. Dhe ku thuhet që në momentin e ndërhyrjes së shërbimeve të policisë është bërë kundërshtim nga ana juaj. Pra, momenti i parë thuhet vetëm kjo fjalë, "kundërshtim". Në pjesën e Prokurorit që u relatua këtu, thuhet qe, kanosur, është kanosur punonjësi i policisë. Kanosja është dispozitë tjetër. Me dhunë psikologjike. Pra, është kanosur me dhunë psikologjike. Ndërkohë që paragrafi citon 236, paragrafi 2). Kështu që ne kërkojmë një sqarim nga Prokurori, pasi mesa duket qarte në këtë proces, ose në fakt kshu ndodh kur ka veprime arbitrare të policisë. Nuk marrin miratim nga Prokurori, ose leje kontrolli nga Prokurori dhe ndodhin, si ka ndodhur ajo e lejes së armës që nuk gjendet për personin tjetër në hetim. Kshu që ne kërkojmë të na sqarohet ky moment. Që të bëjmë mbrojten, se tani ka mospërputhje. Kemi kanosje, kemi...*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Çfarë kërkohet të sqarohet konkretisht?*

***Avokat Ulian Barjami**: Zonja Kryetare!*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Çfarë forme dhune pretendohet nga....*

***Avokat Ulian Barjami**: Pikërisht pra, pikërisht.*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: nga ana e Prokurorisë?*

***Avokat Ulian Barjami**: Sepse momenti i parë, që është i besueshëm si për oficeret por edhe të pandehurit, thuhet kundërshtim. Nuk thuhet as me dhunë, as psikologjike, as me force, as me kanosje, as me një gjë. Prokurori relatoi "kanosje" thotë me dhunë psikologjike. Tani, kanosja e para, është dispozitë më vete. Eshtë me dhunë. Ndërsa te kërkesa thotë me dhunë. Kundërshtim me dhunë. Në cilat nga këto raste jemi? **Se tashi, dikush ka gënjyer**. O policët. Ose s'po e quaj të gënjyer, por kanë thene nje të pavërtetë. **Policet, Prokurori, apo oficerët tani, se kam idenë Kshu që ne duam... të paktën kjo e vë në pikëpyetje akuzën për ne**. Akuzën, dyshimin për konsumim të veprës penale.*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: I arrestuari? Dakord je me Avokatin?*

***Maksim Suçi**: Urdhero? Po dakord jam me Avokatin. Desha të shtoja pak diçka*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Po, patjetër!*

***Maksim Suçi**: Sepse... Momentin unë që hyra në lokal, bashkë me Hansin, unë pashe gjithçka ishin krejt t'rreshtu, krejt ishin me pranga. Pashë që ishte bo gjurulldi aty dhe dal, dolem përjashtë lokalit. Se s'kishim ça boshim mo. Dikush na ka ardh, na ka kap te parkingu i makinës. Duke m'kap me dhunë. **Gjë që s'e pranoj dot**.*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Maksimi është personi i cili është... nga pamjet filmike....*

Maksim Suçi: *As në tavolinë s'kam qenë me askënd. Kam qenë në korridor duke ikur për në lokal.*

Gjyqtari Megi Strakosha*: mbas...mbas.... ketu!*

Prokuror Gjergji Ceka*: Eshtë personi ku rezulton... që ka kërcënu policet.*

Avokat Ulian Barjami*: Mund t'a shikojmë atë? Se nuk e kemi pa?*

Prokuror Gjergji Ceka*: Pra, gjatë kryerjes.....*

Gjyqtari Megi Strakosha*: Këtu mbrapa ke qenë? Mbas lokalit?*

Maksim Suçi*: Po, mbrapa*

Gjyqtari Megi Strakosha*: Ky ketu? Që je?*

Avokat Ulian Barjami*: A ta shoh pak Gjyqtare?*

Maksim Suçi*: Kur kam dal jashtë unë, ka ardh m'ka kap ai. S'kam qenë as në tavolinë, kam qenë duke ecur.*

Avokat Ulian Barjami*: Faleminderit! Faleminderit!...*

Gjyqtari Megi Strakosha*: Ça bluze kishe veshur atë ditë?*

Maksim Suçi*: Te errët kam pas.*

Gjyqtari Megi Strakosha*: Si?*

Maksim Suçi*: Bluze te errët. Te zezë.*

Gjyqtari Megi Strakosha*: Të zezë? Po. Lidhur me kete pretendim Prokuror që ngre mbrojtja? Pra, për llojin e dhunës të ushtruar*

Prokuror Gjergji Ceka*: Pra, une e lexova dhe njëherë, po gjithsesi po e lexoj prape, që t'ja sqaroj mire...*

Avokat Ulian Barjami*: Qëndrimi pra. Prokuror besoj se qëndrimin e dini. Nuk e di a e lexove. Qëndrimi a është i qartë?* ***A jeni zoti i çështjes****?*

Prokuror Gjergji Ceka*: .... po megjithatë.*

Gjyqtari Megi Strakosha*: Avokat nuk mund t'i drejtoheni Prokurorit ashtu, ashtu sikurse dhe Prokurori nuk mund t'ju drejtohet juve.* ***Pra, të ruajmë pak etikën, se po flasim****....*

Avokat Ulian Barjami*: Eshtë çështje qëndrimi.*

Gjyqtari Megi Strakosha*:* ***Eshtë çështje qëndrimi, mbajeni ligjor qëndrimin****. Jo komunikim në këtë mënyrë me asnjë prej palëve në Sallën e Gjyqit. Atëherë i bëtë një pyetje Prokurorit, do ju përgjigjet Prokurori tani*

Prokuror Gjergji Ceka*: Une e dhashë sqarimin para Gjykatës. Ishte shumë ...shume....*

Gjyqtari Megi Strakosha*: Dakord. Avokati do sërish të qartësohet, duke qenë se janë dhe 14 persona*

Prokuror Gjergji Ceka*: Nuk e ka dëgjuar Avokati, por s'është faji im që nuk e ka dëgjuar*

Gjyqtari Megi Strakosha*: Prokuror, të lutem! Ta themi dhe njëherë.*

Prokuror Gjergji Ceka*:.... thotë, shtetasi Maksim Suçi, ka qenë ndër personat qe ka kundërshtuar policinë me forcë. Gjithashtu, i ka kërcënuar. Kjo është formë dhune.*

Maksim Suçi*: Po, se doni ju.*

Gjyqtari Megi Strakosha*: Duke thënë* ***"do t'a shihni se çfarë do t'ju bëj, do ju vras! Kam për t'ju ndjekur gjithë jetën për këtë veprim që po bëni".*** *Kështu ka relatuar,*

kanë thënë, kanë thënë oficerët, policët, që kanë qenë aty dhe kanë bërë raportin e shërbimit.

Maksim Suçi: *Çdo gjë është sajesë zonja Gjyqtare! Eshtë çdo gjë e sajume.*

Avokat Ulian Barjami*: Një sekondë, një sekondë!*

Gjyqtari Megi Strakosha*: Keto janë ato që rezultojnë...*

Avokat Ulian Barjami*: Tani edhe njëherë. U ka thënë "do ta shikoni se çdo t'ju bej"? Kaq?! Kaq apo jo?*

Gjyqtari Megi Strakosha*: Do ju vras, kam për t'ju ndjekur gjithe jetën për këtë veprim që po beni. Do ta shikoni çfarë do t'ju bëj. Dhe kanë, pretendohet qe e ka kundershtuar me forcë policin, siç rezulton nga fotoja që ju tregova.*

Avokat Ulian Barjami*: Po pra, po Prokurori tha dhunë psikologjike Kryetare. Kjo është shume e rendësishme për ne për veprën. Tha dhunë, kanosje, dhune psikologjike. Unë e dëgjova dhe e shënova.*

Gjyqtari Megi Strakosha*: Pretendohet për dhunë fizike apo..?*

Prokuror Gjergji Ceka*: Me force dhe me dhune psikike.*

Avokat Ulian Barjami*: Aaa, dhune psikike.*

Gjyqtari Megi Strakosha*: Tani, e ktheu përgjigjen Prokurori. Mbani ju qëndrimin tuaj!*

Avokat Ulian Barjami*: Zonja Kryetare, e.. sa i përket ligjshmërisë së arrestit, ne e vlerësojmë që arresti është i paligjshëm dhe kërkojmë nga ana juaj që të vlerësohet si i paligjshëm, pasi kontrolli si i lokalit dhe i zotit Sulçe është bërë në kundërshtim me parashikimet e Kushtetutës, pra, konkretisht me Nenin 37 të Kushtetutës, ku do t'a citoj dhe nuk do ta interpretoj, se interpretimin e ka bërë të qartë edhe Gjykata Kushtetuese, edhe vendimi njehsues i Gjykatës së Lartë. Ku thuhet "askujt nuk mund t'i bëhet kontroll vetjak, jashtë procesit penal". E theksoj "jashtë procesit penal", sepse kontrolli vetjak lidhet me një proces të pavarur nga kontrolli, "me përjashtim të rasteve"- thotë, "të hyrjeve në territor të shtetit dhe të daljes së tij, ose "për të mënjanuar një rrezik që i kanoset sigurisë publike". Pra, në rastin konkret nuk jemi as në rastet e një kontrolli për llogari të një procedimi, as në kushtet të një kontrolli për llogari të një ekzekutimi vendimi penal. Gjithashtu, vendimi njehsues i Gjykatës së Lartë, që ka definuar qartë kontrollin është vendimi Nr. 1, i datës 30.06.2017, ku shprehimisht thotë "Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se përveç veprave penale menjëherë të dukshme me sy, nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore nuk është i mundur perdorimi i kontrollit, pa vendim Gjykate dhe me iniciativë të policisë gjyqësore, si mjet për kërkimin e njoftimit të veprës penale. sepse ai së pari, nuk është i parashikuar nga ligji i procedurës penale dhe së dyti do të cënonte thelbin e paprekshmërisë së garantuar nga Kushtetuta dhe nga traktatet e tjera ndërkombëtare në fushën e të drejtave te tjera themelore të njeriut". Pra, bëni një diferencim të qartë, çfarë është kontrolli? Eshtë mjet për kërkimin e provës, apo është mjet për kërkimin e njoftimit të veprës penale? Pra në rastin konkret, kontrolli është përdorur si mjet për kërkimin e njoftimit te veprës penale, pra, pa interpretim...*

Gjyqtari Megi Strakosha*: Që do të thotë?*

Avokat Ulian Barjami: *Gjykata e Lartë, Kolegjet e Bashkuara, me qëndrim njehsues e ka ndarë qartë këtë moment. Pra, punonjësi i policisë nuk mund të marrë një informacion dhe të shkojë të bëjë kontroll. S'ka rëndësi janë 14 veta, 140 veta apo 1400 veta. Numri nuk përbën diferencë. Supozojmë që në një rast, në një sallë dasme merr informacion që dikush nga këta, njeri nga dasmorët, krushqit, kane ardh me vonesë dhe disponon armë pa leje. Policia si vepron? Pa leje të Prokurorit dhe shkon dhe kontrollon të gjithë dasmorët? Ose, merr informacion që në qytetin e Elbasanit, dikush ka armë pa leje. Do të kontrollojë të gjithë qytetin? Ose prezumon në një qytetet, çfarëdolloj qyteti ka individë që posedojnë armë pa leje. lëndë narkotike, çfarëdolloj vepre penale, mund të kontrollohen të gjithë? Dhe prandaj vendimi njehsues i Gjykatës së Lartë e ka përcaktuar qarte. Kerkimi është mjet për njoftimin e veprës penale. Kontrolli është mjet për kërkimin e veprës penale. Gjithashtu, edhe neni, edhe Kodi i Procedurës Penale, e ka përcaktua qartë. Në rast flagrance thotë, kontrollet, neni 298, kontrollet thotë, në rast flagrance, ose në rast të ndjekjes së personit që është duke ikur, oficerët e policise gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të lokalit kur ka arsye të bazuar, të mendojë se në personin gjenden të fshehura sende ose gjurmë të veprës penale që mund te zhduken. Pra, të gjitha lidhen me një vepër penale tjetër. Pra, mjet për kërkimin e provës është kontrolli. Ka ndodhur një vepër tjetër.. si del policia rëndom. Ka ndodhur një vepër penale dhe policia ngrin postobllok, njofton qe ka kontroll policie dhe gjithmonë kontrolli lidhet me kryerjen e një vepre penale. Jo për të gjetur veprën penale aty te vendi kontrollit. Kshu që, vlerësojmë që arrestimi është i paligjshëm.* ***Janë veprime arbitrare të policisë, të cilat ne do t'i ndjekim dhe është e vërtetë ajo që ka pohuar vetë personi nën hetim, që do t'a ndjeki. Dhe ky ka qenë konteksti dhe qëllimi. Që do ta ndjekim. Patjetër që do t'a ndjekim! Deri në fund do t'a ndjekim! Deri në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.***

Gjyqtari Megi Strakosha: *Kush ka qenë konteksti i këtij...*

Avokat Ulian Barjami: *Ky është konteksti që do t'a ndjekim.*

Gjyqtari Megi Strakosha: ***Ça do me thënë do t'a ndjekim. Ma vazhdo fjalinë! Se nga aktet e policisë ka lloj tjetër ndjekje, siç referon policia dhe nëse ju i qëndroni....***

Avokat Ulian Barjami: *Së pari, zonja Gjyqtare, së pari...*

Gjyqtari Megi Strakosha: *Deklarimit që pretendohet që ka dhënë.....*

Avokat Ulian Barjami: *Policia duket sa korrekte është....duket sa korrekte është...*

Gjyqtari Megi Strakosha: *Atëherë, ma saktëso pak qartë zoti Avokat, se nuk mund te bëjmë lojëra fjalësh me të ndjekur policinë. Se policia bën punën e vet.* ***Dhe nuk kërcënohet policia!***

Avokat Ulian Barjami: *Patjetër, veprime arbitrare. Patjetër! Zonja Gjyqtare, policia i ka kërcënuar ata.*

Gjyqtari Megi Strakosha: *Kështu që ma përsërit dhe njëherë çfarë doje të thoje! Sa më qartë të jetë e mundur.*

Avokat Ulian Barjami: *Do të t'a citojë si e ka shkrujt policia. Po e marrim të mirëqenë policinë, po policia duhet marrë me rezervë në këtë rast.*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Dakord, po mos u mbivendos kur flas unë, flisni dhe ju!*
***Avokat Ulian Barjami**: Gjyqtare!*
***Gjyqtari Megi Strakosha**: Atëherë, ma riformulo dhe njëherë fjalinë të lutem! Po të jap dhe njëherë mundësinë dhe të ma riformulosh edhe njëherë atë fjalinë që the. sa më qartë të jetë e mundur!*
***Avokat Ulian Barjami**: Po po, t'a gjej, t'a gjej tani*
***Gjyqtari Megi Strakosha**: Jo ta lëmë të nënkuptuar se...*
***Avokat Ulian Barjami**: Po.*
***Gjyqtari Megi Strakosha**: Nuk ju lejohen juve këto lloj sjelljesh në Sallën e Gjyqit! Në rregull? Vazhdo! Unë t'a përmenda tre herë çfarë ka thënë policia që ka thënë zoti Maksim Suçi.*
***Avokat Ulian Barjami**: Megjithatë, kjo vetëm sipas policisë.*
***Gjyqtari Megi Strakosha**: ju thatë do i qëndrojmë....*
***Avokat Ulian Barjami**: Jo, s'thashë do i qëndrojmë... logjika...*
***Gjyqtari Megi Strakosha**: Do ta ndjekim. Ma sqaro dhe njëherë tani.*
***Avokat Ulian Barjami**: Logjika dhe thashë konteksti kush ka qenë.*
***Gjyqtari Megi Strakosha**: Ma sqaro dhe njëherë të jemi të qartë.*
***Avokat Ulian Barjami**: Do t'a shikoni çfarë do ju bëj. Do ju vras! Kam për t'ju ndjekur gjithë jetën për këtë veprim që po bëni. Përveç fjalës "do ju vras", Gjyqtare ne duhet të kuptojmë.. aty ka qenë një drekë, ka shkuar policia. Kanë qenë duke ngrënë. I ka çuar në këmbë. Tani, nuk jemi standard i vitit '96. Që të vjen policia, të çon në këmbë, je duke ngrënë, të çon në këmbë, të mbështet mbas murrit...*
***Gjyqtari Megi Strakosha**: Po çfarë duhet të bënte? Të priste të hanin drekën? Tani flasim pak më seriozisht!*
***Avokat Ulian Barjami**: Zonja Gjyqtare unë...*
***Gjyqtari Megi Strakosha**:... një kontroll.. ka marrë një informacion policia që në atë ambient ka arme. Ka kontrolluar personat që ndodheshin atje.*
***Avokat Ulian Barjami**: Së pari, kjo nuk është e ligjshme se e citova.*
***Gjyqtari Megi Strakosha**: Po, ma arsyetove këtë sepse më përmende Kushtetutën, Vendimin e Gjykatës së Lartë. Po, ka diçka tjetër?*
***Avokat Ulian Barjami**: Tani, sa i përket këtij momenti... kanë qenë duke drekuar. Policia ka vajtur i ka çuar në këmbë "Çohuni sepse do të kontrollojmë "apo jo? Pa leje kontrolli, apo jo? Se kjo është e rëndësishme. Dhe mendoj që ky është momenti më i rëndësishëm. Sepse aty mund të ketë dyshime që mund të kishin edhe raketa këta.*
***Gjyqtari Megi Strakosha**: Me fal...*
***Avokat Ulian Barjami**: Megjithatë zonja Gjyqtare....*
***Gjyqtari Megi Strakosha**: Maksim, the që nuk ishe pjesë e drekës, apo ishe pjesë e drekës?*
***Maksim Suçi**: Zoti Avokat vetëm një sekondë. Zonja e Nderume Gjyqtare!*
***Gjyqtari Megi Strakosha**: Po, ishe pjesë e drekës atje?*
***Maksim Suçi**: Mund te flas? Nuk isha fare pjesë e drekës, kam qenë duke u futur në lokal.*
***Gjyqtari Megi Strakosha**: Sepse po merremi u çuan ata nga dreka Qendrojmë pak...*

***Maksim Suçi**: S'ka qenë asnjë duke ngrënë drekë. Thjesht kam parë njerëz...apo jo.*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Kontrollin e personit që ju përfaqësoni, të lutem. Se ai thotë s'isha në drekë, kam ardhur pas. Pasi ata persona ishin të kapur nga policia. Kështu që qëndrojmë pak te ai që ju përfaqësoni*

***Maksim Suçi**: Mund të sqaroj. Sapo kam hyrë....*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Më fal, se nuk të dëgjoj Maksim. Kur Gjykata flet, të mbaroj njëherë unë, pastaj flisni ju, se flisni dhe nuk dëgjohemi. Do të konsultohesh me Avokatin?*

***Maksim Suçi**: Jo, vetëm kaq, mund të dëgjosh dhe ti, nuk kam gjë për t'u konsultu.*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Atëherë, nuk jemi këtu për të bërë analizën e punës së policisë në tërësi. Do merremi me personin që ju përfaqësoni, ju lutem, se janë 14 persona, kështu që...*

***Avokat Ulian Barjami**: Zonja Gjyqtare! Së pari, së pari.. se ky moment, kjo shprehja që ka cituar policia që nuk e dimë sesa e vërtetë është, po e marrim te mirëqenë. **Ka të bëjë, sepse unë jam konsultuar edhe me personin që përfaqësoj**. Ideja është që është paligjshmëri sepse nuk mund të kontrollohet personi vend e pa vend.*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Pra, ju pretendoni që kontrolli është i paligjshëm?*

***Avokat Ulian Barjami**: Patjetër që është i paligjshëm!*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Pasojat e kësaj që ju pretendoni, cilat janë?*

***Avokat Ulian Barjami**: Zonja Gjyqtare! Pasojat, po pasojat nuk lidhen me këtë. sepse ky nuk është kapur ky me armë. Që të kërkojme ne është i ligjshëm apo s'është i ligjshëm. ***

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Po atëherë për çfarë i hyjmë kontrollit nëse s'i është gjetur asnjë send këtij personit? Mund të vazhdojmë pak për ekonomi gjyqësore?*

***Avokat Ulian Barjami**: Për paligjshmëri zonja Gjyqtare. Paligjshmëria, kontrolli. pikërisht pra se nuk është gjetur asnjë send.*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Po mirë, e zemë se konstatoi Gjykata që është i paligjshëm kontrolli, atëherë çfarë lidhje ka kjo...*

***Avokat Ulian Barjami**: Po nuk ka kundërshtim. S'ka se është veprim i paligjshëm. është veprim arbitrar i punonjësit të policisë*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Atëherë, ju pretendoni që Maksimi ka bërë këtë vlerësim ligjor në momentin që është kontrolluar nga policia... dhe duke... çfarë arsimi kishe ti Maksim?*

***Maksim Suçi**: Të mesëm.*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Të mesëm. Po.*

***Avokat Ulian Barjami**: Tani e di çdo qytetar zonja Gjyqtare që kur shkohet për kontroll shkohet me mandat kontrolli.*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Dhe ka bërë këtë analizë Maksimi që kontrolli është i paligjshëm dhe ka kërcënuar duke i thënë do t'ju vras.*

***Avokat Ulian Barjami**: Jo, të gjithë kanë kërkuar, se ata kanë qenë të gjithë bashkë, keni leje kontrolli, s'keni leje kontrolli? Tani, këtë e di çdo qytetar që duhet një leje kontrolli kur vjen çdo polic të të kontrollojë. Dhe ky ka qenë konteksti.*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Po. Dhe në kushtet e një kontrolli të paligjshëm, ai ka reaguar në atë mënyrë që thoni ju? Shkak-pasojë.*

***Avokat Ulian Barjami**: Kush është mënyra? Sa i përket, sa i përket kundërshtimit zonja Gjyqtare...*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Mënyra për ato fjalitë që thatë ju, e zëmë që janë thënë kështu, apo jo? Po pra, kjo është mënyra, se tani nuk do bëjmë pyetje përgjigje. debat me Gjykatën, Avokat, të lutem!*

***Avokat Ulian Barjami**: Po më ndërpret Gjyqtare!*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Nuk po të ndërpres, po të orientoj, tek i arrestuari që t'i përfaqëson. Se gjykata qartësohet, se Gjykata do qartësohet këtu, se Maksimi e di ça ka bërë, Prokurori i qëndron akuzës, kërkesës së vet.*

***Avokat Ulian Barjami**: Edhe Maksimi qeparë e shprehu që unë nuk kam qenë në lokal. Janë kontrolluar të gjithë personat që kanë hyrë dhe kanë dal. Edhe mbas momentit të tavolinës. Dhe Maksimi nuk ka bere rezistencë se kjo rezulton nga aktet. Lëre çfarë them unë dhe çfarë thotë Maksimi. Se Maksimi mund të thotë një të pavërtetë se do të mbrohet. Thotë kundërshtim.*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Cilit akt i referoheni aty të lutem?*

***Avokat Ulian Barjami**: Verbali per arrestimin në flagrance të shtetasit Maksim Suçi*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Po.*

***Avokat Ulian Barjami**: Dhe thote "Keni bërë kundërshtim nga ana juaj sëbashku me personat prezent në tavoline". Tani kush është e vërteta këtu? Kanë qenë në tavolinë? Kanë qenë jashtë? Ndërkohë te kërkesa e Prokurorit thotë kundërshtim me dhunë. Madje vazhdon Prokurori. Kundërshtim me dhunë, kanosje me dhunë psikologjike thotë Prokurori. Është e regjistruar në audio zonja Gjyqtare!*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: E saktësoi dhe tha fizike dhe psikologjike, të dyja, apo jo?*

***Prokuror Gjergji Ceka**: Po.*

***Avokat Ulian Barjami**: **Tani me sajesa mund t'a bëjmë**.*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Po nuk janë sajesa Avokat! Tani Prokurori tha.. Më fal kërkove qëndrimin e Prokurorit, t'a mbajti në seancë. Tani të lutem, komentet, për here te fundit, komentet lejohen në këtë Sallë! Dakord? Te lutem përqendrohu te mbrojtja e personit që përfaqëson. Se unë nuk jam fare e qartë se çfarë po kërkoni deri në këto momente.*

***Avokat Ulian Barjami**: Zonja Gjyqtare unë konstatoj parregullsi në aktet, prandaj kam shqetësim, se...*

Gjyqtari Megi Strakosha**: Avokat, të lutem qartëso Gjykatën se çfarë po kërkon? Dhe koncentrohu pak të lutem. **Gjykata nuk bindet nëse ju bëni komente për Policinë apo për Prokurorinë. Nëse është kjo metodë e mbrojtjes, ndryshoni metodën e mbrojtjes, të lutem!

***Avokat Ulian Barjami**: Gjyqtare nuk mund të bëj një përgjigje tani? E? Te lutem? Tani, unë i referohem vetëm verbal, nuk bëra koment. Dhe veprimeve të policisë iu referova vendimit të Gjykatës së Lartë.*

Gjyqtari Megi Strakosha**: Jepi drejtim Avokat. Ke maksimumi 5 minuta kohë për të përfunduar mbrojtjen tënde. *

Avokat Ulian Barjami**: Të gjitha këto Zonja Gjyqtare, ne vlerësojmë që për sa kohë **është bërë një precedent i rrezikshëm në fakt në sistemin tonë, që çdo veprim arbitrar i policisë, miratohet nga Prokurori, kryesisht arrestimet.** Ka patur një reagim edhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si publik dhe zyrtar për të mos u abuzuar me arrestime, por ca kohë u mbajt parasysh dhe u harrua. Por, ajo që unë e ndesh shpesh nëpër procese është që drejtësia është mision. **Nëse drejtësia shikohet thjesht për të marrë pagën, për të blerë ato....

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Tani, do vazhdoni me mbrojtjen tuaj? Se nuk janë në funksion të mbrojtjes tuaj këto. Gjykata e di ligjin dhe punën e vet. Në rregull?*

***Avokat Ulian Barjami**: E kisha për Prokurorin!*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Po, po ju thatë Gjykata*

***Avokat Ulian Barjami**: Përfundimisht kërkojmë vleftësimin e paligjshëm të arrestit në flagrancë dhe të mos caktohet asnjë masë sigurimi ndaj shtetasit Maksim Suçi. Faleminderit!*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Faleminderit!"*

13. Nga dëgjimi regjistrimit audio në dokumentin me emërtim "Sallal_20251017-1446_01dc3f74acfa44dc0", paraqitet me interes për hetimin, biseda e zhvilluar në seancën gjyqësore, ku dallohet komunikimi ndërmjet Gjyqtarit Megi Strakosha, Prokurorit Gjergji Ceka dhe Mbrojtësit të personit nën hetim Maksim Suçi, avokat Ulian Barjami.

***Mbrojtësi Av. Ulian Barjami**: Thuhet nga Prokuroria që kanë qenë 14 (katërmbëdhjetë) persona në tavoline. Nga pamjet filmike nuk është... **ose është e pavërtete**. Në tavolinë kanë qenë 6 (gjashtë) persona. U numëruan nga ne dhe nga ju bashkë... nuk e di a janë parë më parë këto pamje nga Prokurori.*

***Prokurori Gjergji Ceka**: Ça ka me Prokurorin ai e vlla... Ça pune ka Prokurori... Prokurori Ça ke ti "Prokuror... Prokuror....". Ore fol për akuzën.*

***Mbrojtësi Av. Ulian Barjami**: Po pra, flitet me leje ne Salle.*

***Prokurori Gjergji Ceka:** Fol për akuzën, o vlla*

***Mbrojtësi Av. Ulian Barjami**: Prokuror kur fola unë... nuk ndërpreva gjë fare*

***Prokurori Gjergji Ceka**: Ore Zotni, ti fol për akuzën, për dyshimin... dyshimin që është....*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Qetësi në Sallë!*

Mbrojtësi Av. Ulian Barjami**: **Zotëri ka të dhëna të pavërteta. Zonja Gjyqtare këtu konstatojmë pasqyrim të të dhënave të pavërteta.

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Avokat fokusohuni te mbrojtja përpara Gjykatës që jua thashë edhe në fillim...*

***Mbrojtësi Av. Ulian Barjami** të pavërteta.*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Se nuk është mbrojtje efektive **nëse sulmoni të gjitha palet qe ju doni**.... nuk është se bindet Gjykata në këtë formë. Të lutem përqendrohu te faktet!*

***Prokurori Gjergji Ceka**: Aty po flitet për fakte, per prova, per ligje.*

Mbrojtësi Av. Ulian Barjami**: Tani, kërkesa e Prokurorit per vleftësim, per vleftësim arresti dhe për caktim mase, bazohet te disa prova, apo jo? Një ndër to tregon që ka pasqyrim të rreme të të dhënave. **Dhe që do të merrem personalisht edhe me Prokurorin, edhe me të gjithë oficerët policisë gjyqësore...

***Prokurori Gjergji Ceka**: aaa.. jo jo...*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Avokat! Avokat!*

***Mbrojtësi Av. Ulian Barjami**.... do të bëj kallëzim.....*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Hera e fundit që.....*

***Prokurori Gjergji Ceka**: Do te arrestohet ai.....*

***Mbrojtësi Av. Ulian Barjami**: Zonja Gjyqtare.... do të bëj kallëzim.....*

Gjyqtari Megi Strakosha**: **Avokat! Avokat! Nuk funksionon me kërcënim në Sallën e Gjyqit!

***Mbrojtësi Av. Ulian Barjami**: Me rrugë ligjore.... jo....*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Nuk ka rëndësi se çfarë do të bëni ju jashtë kësaj Salle. me kë të doni ju. Të thashë... Avokat do marr masa nga ato që parashikon Kodi i Procedurës. Këto lloj komunikimi në këtë Sallë Gjyqi, me mua si Gjyqtare, nuk të lejohen! Përqendrohu te mbrojtja që do i bësh të pandehurit tënd! Ose do ti caktoj ndonjë avokat tjetër kryesisht dhe do të nxjerr përjashta! Avokat nëse vazhdon me këtë gjuhë komunikimi. Përqendrohu te mbrojtja po te them! Paralajmërimi i fundit!*

***Mbrojtësi Av. Ulian Barjami**: Pasqyrim të të dhënave të rreme, si nga policia, si nga Prokuroria. E pamë të gjithë qartë që as nga shtetasi Maksim Suçi, as nga persona të tjerë nuk ka kundërshtim. **Nuk ka qenë fare ne tavolinë**. Kështu që përfundimisht, kërkojmë vleftësimin e paligjshëm të arrestit dhe mos caktimin e asnjë mase sigurie.*

***Gjyqtari Megi Strakosha**: Faleminderit!"*

14. Në lidhje me sa më sipër është pyetur **Ulian Barjami,** i cili ka shpjeguar ndër të tjera në lidhje me regjistrimin audio të seancës, se sipas tij është shumë e qartë se e gjithë biseda dhe i gjithë konteksti ka qenë krejtësisht ligjor, duke pasur parasysh që ai konstatoi se procesverbali i arrestimit të shtetasit Maksim Suçi, paraqiste të dhëna të pavërteta. Ai më tej shpjegon se i është drejtuar Gjykatës me një ton krejt të zakonshëm duke i thënë që konstatojnë se nga Prokuroria dhe nga policia gjyqësore janë paraqitur rrethana të pavërteta që përbëjnë vepër penale dhe këtë çështje do t'a ndjekë personalisht, me qëllim për të siguruar të drejtat e personit që përfaqëson. Ulian Barjami shpjegon se ka thënë që do të bëjë kallëzim penal, ndaj Prokurorit dhe oficerëve të policisë gjyqësore. Në këtë moment, Prokurori ka çuar tonin e zërit, madje duke bërtitur se çfarë janë këto gjëra, çfarë ke me mua, sepse do të arrestoj. Pastaj ka ndërhyrë Gjykata dhe diskutimi ka përfunduar. Ulian Barjami shpjegon se pas këtij momenti, në konkluzione ka kërkuar vlerësimin si të paligjshëm të arrestit, me arsyetimin se sipas tij nuk kishte vepër penale, pasi të gjitha provat e sjella nga Prokuroria paraqisnin rrethana të rreme. Ulian Barjami thekson, se nuk ka pasur asgjë personale me Prokurorin, as e njeh, as ka pasur konflikte të mëparshme, dhe nuk ka asnjë arsye për ta bërë atë për të cilën dyshohet.

15. Gjithashtu në lidhje me ngjarjen është pyetur prokurori Gjergji Ceka, i cili ka sqaruar se: *"Unë aktualisht punoj ne Prokurorinë Pranë Gjykatës Shkalles Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Elbasan ne detyrën prokuror. Ne datën 17.10.2025 ne procesin gjyqësor me objekt vlerësimin e arrestimit ne flagrance dhe caktimin e masës se sigurimit personal ndaj shtetasve Maksim Suci, Bujar Muca, Enderi Doda, Akil Kertusha etj, qe nisi rreth ores 11:00. jam kanosur për shkak te detyrës sime qe ushtroj si prokuror, jam kundërshtuar me dhune verbale gjate ushtrimit te detyrës dhe për shkak te saj, nga avokati i shtetasit te arrestuar Maskim Suçi, z.Uljan Barjami. Gjate debatit gjyqësor avokati Barjami ka shprehur disa here fraza kërcënuese si dhe ndaj punonjësve te policisë gjyqësorë. Mua me është drejtuar personalisht dhe jo nëpërmjet gjykatës disa here me tone kërcënuese. Me ka ndërprere disa here fjalën gjate paraqitjes se argumenteve nga ana ime ne lidhje me çështjen.*

16. *Nga aktet e çështjes qe ishte ne shqyrtim rezultonte se personi ne hetim Maksim Suci kishte kërcënuar me jete punonjësit e policisë te përfshire ne vendngjarje me fjalët: "Do to shikoni se çfarë do ju bej, do ju vras, do ju ndjek gjithë jetën". Gjate debatit gjyqësor shtetasi Uljan Barjami përsëriste fraza kërcënuese duke thënë se te drejte kishte klienti i tij pasi do ti shkonin deri ne fund. shtetasi Barjami mundohej te mbulonte kanosjen e kryer nga klienti i tij duke thënë se "Do ta ndjekim ligjërisht. Edhe pas këtij momenti, shtetasi Barjami ndërhynte ne fjalën time dhe drejtohej personalisht duke sulmuar prokurorin dhe jo duke folur per provat dhe bazen ligjore qe lidhet me çështjen. Kjo gjë i është bere e ditur dhe vene ne dukje disa here nga ana e prokurorit dhe kryesisht nga ana e gjykatës.*

17. *Gjatë seancës janë shfaqur edhe pamjet filmike te ngjarjes ku rezultoi qarte se i mbrojturi prej av. Barjamit, kishte kundërshtuar me dhune punonjësit e policisë duke i shtyre disa here me duar. Pavarësisht se u duk qarte kundërshtimi i kryer prej tij, sërish avokati Uljan Barjami deklaroi se prokurori ka paraqitur te dhëna te rreme.*

18. *Me tej avokati Uljan Barjami ka kërcënuar prokurorin e çështjes dhe oficeret e policisë gjyqësore duke deklaruar ne seance gjyqësore" Do te merrem personalisht me prokurorin dhe oficeret e policisë gjyqësore". Menjëherë kam ndërhyrë unë dhe me pas gjykata e cila i sqaroi se nuk mund te bente dhe thoshte te tilla kërcënime. Avokati Barjami u perpoq serisht ta kamufloje këtë kërcenim duke pretenduar dhe deklaruar se do ta ndiqte çështjen ne rruge ligjore.*

19. *Pavarësisht kësaj, mesazhi kërcënues per prokurorin u përçua qarte. Ky veprim u krye me qellim ndikimin e veprimtarisë se ligjshme te institucionit te prokurorisë nëpërmjet kanosjes dhe dhunës verbale. Gjithashtu janë kanosur edhe oficeret e policisë qe kane marre pjese ne këtë çështje.*

20. *Pas ndërprerjes se seancës gjyqësore nga gjykata e cila u tërhoq per te dhënë vendim, lidhur me këtë ngjarje qe ju sqarova me lart, kam njoftuar me shqetësim drejtuesin e prokurorisë Elbasan z. Kreshnik Ajazi si dhe policinë e shtetit.*

21. *Theksoj se nga pikëpamja ligjore kanosja e gjyqtarit, nuk kërkon te kryhet për vrasje apo plagosje te rende. Për shkak te natyrës se veprimtarisë se organeve te drejtësisë kjo vepër penale kryhet me çdo lloj fjale, vepre, apo simbolike qe synon te përçojë frike dhe te intimidojë autoritetet e drejtësisë, per te ndikuar ne vendimmarrjen e tyre..."*

22. Me shkresën nr 26959, datë 22.10.2025, organi procedues ka kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan, kopje të akteve të procedimit penal nr.1188/2025 i regjistruar pranë kësaj prokurorie në ngarkim të shtetasit Maksim Suçi. Nëpërmjet shkresës nr.11198, datë 29.10.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan ka përcjellë aktet e procedimit në fjalë duke specifikuar që kjo çështje është ende nën hetim. Nga të dhënat e këtij procedimi penal rezulton se në datë 13.10.2025, ora 14:58, salla operative e Drejtorisë Vendore të Policisë, Elbasan ka marrë njoftim se në restorantin "Zikollari" kishin shkuar disa persona të armatosur. Menjëherë punonjësit e policisë të Drejtorisë Vendore Elbasan, kanë shkuar në ambientet e këtij lokali dhe në tavolinën ku ishin ulur disa persona janë gjetur disa çanta dore kur në dy prej tyre janë gjetur sende të dyshuara si armë zjarri të llojit pistoletë. Midis tyre dyshohet se ka qenë dhe shtetasi Maksim Suçi, i cili ka deklaruar që nuk ka patur armë me vete dhe nuk ka kundërshtuar asnjë punonjës policie. Policia gjyqësore, në kushte flagrancës ka bërë arrestimin e këtij shtetasi në cilësinë e personit të dyshuar për kryerjen e veprave penale "*Kundërshtimi i punonjësit të policisë të rendit publik*", "*Prodhimi dhe mbajtja pa leje armëve luftarake dhe e municionit*" dhe "*Moskallëzimi i krimit*" të parashikuara nga nenet *236, 278 dhe 300 dhe 25* të Kodit Penal. Nga ana e prokurorit të çështjes është kërkuar para Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, vleftësimi i ligjshëm i arrestit në flagrancë dhe caktimi i masës së sigurimit "Arrest në burg" për të arrestuarin në flagrancë Maksim Suci.

23. Organi procedues me shkresën nr.26959, datë 22.10.2025, ka kërkuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan, kopje të regjistrimit video të seancës së daës 17.10.2025 me objekt vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masave të sigurimit ndaj 14 personave të arrestuar më datë 13.10.2025, si dhe kopje të vendimit të marrë nga gjykata në përfundim të kësaj seancë në lidhje me të arrestuarin Maksim Suçi. Me shkresën nr.2078/1, datë 18.11.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan, ka dërguar aktet e sipërcituara. Nga dëgjimi i përmbajtjes së videos së kësaj seance evidentohet që ajo përputhet me tranksriptimin e bërë nga policia gjyqësore në datë 18.10.2025.

24. Gjithashtu, figuron që me vendimin nr.658, datë 17.10.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan, ka vlerësuar të ligjshëm arrestimin e shtetasit Maksim Suçi për veprat penale "*Moskallëzimi i krimit*", "*Kundërshtimi i punonjësit të policisë të rendit publik*" të parashikuara nga nenet 236/2 dhe 300 të Kodit Penal. Ndërsa arrestimin e tij për veprën penale "*Prodhimi dhe mbajtja pa leje armëve luftarake dhe e*

municionit" e ka konsideruar të paligjshëm. Gjykata, ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit personal "*Arrest me burg*" në cilësinë e personit nën hetim për kryerjen e veprave penale "*Moskallëzimi i krimit*", "*Kundërshtimi i punonjësit të policisë të rendit publik*", të parashikuara nga nenet 236/2 dhe 300 të Kodit Penal si dhe për veprën penale "*Kanosja për shkak të detyrës*" të parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal, e cila nuk ishte përcaktuar në kërkesën e Prokurorit të çështjes, por është vlerësuar nga gjykata që kishte dyshime të arsyeshme që shtetasi Maksim Suçi, kishte konsumuar dhe këtë vepër penale.

25. Në datë 31.10.2025, nga policia gjyqësore është pyetur shtetasi Platon Mali në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale. Ai ka deklaruar që është punonjës policie në Forcën e Posaçme "Shqiponja" në Drejtorinë Vendore të Policisë, Elbasan. Raporti i shërbimit të datës 17.10.2025, është përpiluar prej tij dhe kolegut Azem Bardhi me detyrë përgjegjës i dhomave të sigurimit. Ky raport është përpiluar për ngjarjen e ndodhur një ditë më parë në datë 17.10.2025, më sallën nr.1 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan. Raporti është përpiluar prej tyre pasi kjo gjë iu është kërkuar nga ana e shtetases Zmeralda Mëhilli me detyrë Oficere e Policisë Gjyqësore, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan. Në datë 17.10.2025, ka qenë seanca gjyqësore për vleftësimin e masës së sigurimit për 14 të arrestuar lidhur me ngjarjen e datës 13.10.2025. Midis këtyre të arrestuarve ka qenë dhe shtetasi Maksim Suçi. Deklaruesi ka qenë pjesë e grupit të shoqërimit të këtyre të arrestuarve ku në përbërje të këtij grupi kanë afërsisht 20 punonjës policie. Në sallën e gjyqit kanë mbërritur rreth orës 11:00 dhe kanë futur në kafaz 13 të arrestuar, Mes tyre ka qenë dhe një i mitur për të cilin iu është kërkuar nga gjykata që ta kalonin në sallën e gjyqit në prezencë të psikologes, punonjëses sociale të Bashkisë Elbasan dhe nënës kujdestare. Pra ky i mitur, nuk ka qenë në kafaz bashkë me 13 të arrestuarit e tjerë por mbahej në sallë nga ai dhe kolegu i tij Azem Bardhi. Në sallën e gjyqit ka qenë prezent ai dhe kolegu Azem Bardhi dhe nuk ka patur punonjës të tjerë policie prezent. Gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore kur fjalën e kishte Avokati Ulian Barjami që përfaqësonte të arrestuarin Maksim Suçi, ka patur një debat verbal mes tij dhe Prokurorit Gjergji Ceka. Në debat e sipër, avokati Ulian Barjami i është drejtuar me fjalët "*se do merrej personalisht me prokurorin Gjergj Ceka dhe oficerët e policisë gjyqësore që ishin marrë me arrestimin e tyre*". Vetëm këtë debat ka dëgjuar midis tyre, fjalë të cilat i kanë përmendur dhe në raportin e shërbimit të përpiluar prej tyre. Pas këtyre fjalëve ka ndërhyrë gjyqtarja e seancës duke i thënë avokatit që të merrej me mbrojtjen e klientit të tij. Në gjykatë janë paraqitur rreth orës 11:00, ndërsa seancë gjyqësore ka filluar rreth orës 11:30, pasi janë sistemuar të gjitha palët. Kjo seancë gjyqësore mund të këtë zgjatur mbi 6 (gjashtë) orë. Gjatë kësaj kohe shtetasi Maksim Suçi ka qenë në kafaz bashkë me të arrestuarit e tjerë, në krah të majtë të vendit ku ndodhej i ulur gjyqtari i çështjes. Ai dhe kolegu i tij Azem Bardhi kanë qenë të pozicionuar në afërsi të të miturit, pranë psikologes, punonjëses sociale dhe nënës kujdestare rreth tre metra larg vendit ku ishte ulur prokurori i çështjes. Pra, kanë qenë në gjendje të dëgjonin debatet mes palëve por jo se kanë qenë të përqendruar në debatin gjyqësor që është zhvilluar atë ditë. Nuk i kanë fiksuar të gjithat debatet që kanë patur palët. Ai ka dëgjuar avokatin Ulian Barjami, i cili gjatë mbrojtjes

së të arrestuarit i është drejtuar Prokurorit të çështjes Gjergji Ceka me fjalët se do merrej personalisht me të dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore. Toni i përdorur nga ky avokat ka qenë pak i ngritur dhe për këtë arsye ka ndërhyrë dhe gjyqtarja e seancës duke thënë që të fokusohej tek mbrojtja dhe të mos komunikonte me prokurorin në këtë pjesë. Ai nuk e ka fiksuar nëse Prokurori Gjergji Ceka ka bërë ndonjë reagim pas këtyre fjalëve të Avokatit Ulian Barjami apo të fjalëve që ai mund të ketë përdorur. Ata si grup shoqërimi nuk kanë ndërhyrë pasi nuk ka patur ndonjë situatë të agravuar mes palëve dhe seanca ka vijuar në normalitet deri në përfundimin e saj. Ky episod është pasqyruar në mënyrë korrekte dhe në raport shërbimin e përpiluar prej tyre në datë 18.10.2025, lidhur me ngjarjen e datës 17.10.2025. Nuk është në gjendje që të ndajë pjesën nëse sjella e Avokatit Ulian Barjami në seancë gjyqësore mund të konsiderohet kërcënuese apo vetëm reagim verbal gjatë debatit. Me avokatin Ulian Barjami nuk ka njohje të mëparshme dhe kjo ka qenë hera e parë që e është përballur me të.

26. Nga policia gjyqësore është pyetur dhe shtetasi Azem Bardhi në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale. Ai ka deklaruar që është punonjës policie pranë Drejtorisë Vendore të Policisë, Elbasan dhe ka përpiluar raportin e shërbimit të datës 18.10.2025, bashkë me kolegun e tij Platon Mali. Rezulton se deklarimet e këtij shtetasi janë në harmoni me ato të bëra nga shtetasi Platon Mali.

27. Sa më sipër Prokuroria pranë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i është drejtuar kësaj Gjykate me kërkesë për pushimin e ceshtjes penale nr.7882/2025, për veprat penale *"Kanosja për shkak të detyrës", "Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit" dhe "Kanosja e gjyqtarit"*, parashikuar nga nenet 238/3, 316 dhe 317 Kodit Penal.

III. Vlerësimi i Gjykatës.

28. Gjykata si shqyrtoi përmbajtjen e kërkesës dhe provat bashkëlidhur saj, konkludoi se kërkesa e prokurorisë është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet të pranohet.

29. Gjykata çmon të theksoi se përgjegjësia penale është detyrimi ligjor i çdokujt që shkel një rregullim normativ me karakter penal, për t'iu nënshtruar pasojave ligjore me karakter ndëshkues e parandalues. Nisur nga rëndësia që kanë organet proceduese penale përgjatë të gjithë veprimtarisë që përbën në tërësi procedimin penal, nga intensiteti i madh i kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të subjekteve të nënshtruara dhe nga nevoja për zhvillimin e një procedimi të ndershëm, të rregullt dhe tërësisht në përputhje me ligjin, Kodi Penal ka parashikuar disa kushte kumulative që duhet të përmbushen në çdo procedim penal.

30. Kushtetuta e Republikës sonë në nenin 39 të saj përcakton ndër të tjera se: *"Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj ..."*, i cili njihet edhe me parimin latin *"Nullum*

crimen, nulla poena sine legge", d.m.th. nuk ka krim, nuk ka ndëshkim pa ligj. Në bazë dhe në zbatim të këtij përcaktimi rezervë ligjore, Kodi Penal fillimisht në nenin 1 dhe më pas në nenin 2 të tij, respektivisht nën titujt *"Ligji penal dhe ndarja e veprave penale"* dhe *"Mosdënimi pa ligj"*, përcakton se *"Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat në pjesën e posaçme të këtij Kodi"* dhe *"Askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër penale që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale. Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj."* Sigurisht, legjislatori nuk do të mjaftohej kurrsesi me kaq, kështu që, në pjesën e posaçme të Kodit Penal ka parashikuar edhe llojet e veprave penale dhe llojet apo masat përkatëse për to.

31. Pra, sipas të drejtës sonë penale e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale është që në veprimet ose mosveprimet e tij të ekzistojnë elementët e një figure të caktuar të veprës penale, të parashikuar nga ligji penal.

32. Kërkesa e prokurorit në rastin konkret gjen parashikim në nenin 329/a të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht: *"1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328 të këtij kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes"*. Ndërsa në nenin 328/1/1 të K.Pr.Penale përcaktohet se: *"Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur:* ***a) del qartë se fakti nuk ekziston****; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; c) viktima nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij; ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet; d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhet të vazhdojë;* ***dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai;*** *e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale; ë) i pandehuri vdes; f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj"*.

33. Gjykata, paraprakisht evidenton faktin se për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj të marra së bashku, të cilët janë: a) objekti i veprës penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive. Provueshmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Gjithashtu, vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjithë elementëve të figurës së saj. Ajo konsiderohet e kryer në mënyrë të plotë atëherë kur ekzistojnë të katër elementët e saj: objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive. Nëse mungon njëri prej këtyre elementëve, vepra penale nuk ekziston. Prandaj, në çështjen konkrete, Gjykata, duhet të shohë e të verifikojë, ekzistencën e të gjithë elementëve të veprës penale dhe të figurës së saj në veçanti. Figura e veprës penale, pasqyron formën juridike të veprës penale për

rastin konkret. Nëse nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë personi, nuk mund të dënohet.

34. Në lidhje me veprën penale *"Kanosja për shkak të detyrës"*, parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal, kjo dispozitw parashikon se: *"Kanosja serioze për vrasje apo për plagosje të rëndë, që i bëhet punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore ose të shërbimit, dënohet me burgim deri në dy vjet. Kur kjo vepër kryhet ndaj personit të zgjedhur apo funksionarit publik për shkak të veprimtarisë së tij, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet. Kur kjo vepër kryhet ndaj punonjësit të policisë për shkak të veprimtarisë së tij, kur cilësitë e personit janë të njohura ose të dukshme, dënohet me burgim nga dy deri në katër vjet."*.

35. **Objekti** i kësaj vepre penale, janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj per te siguruar veprimtarine e rregullt te institucioneve shtetërore publike, të funksionimit të rregullt të tyre, për të mos u ndikuar në kryerjen e detyrave dhe funksioneve publike nga aferat korruptive, marrëdhënie këto të mbrojtura me legjislacionin penal nga veprimet apo mosveprimet kriminale. **Nga ana objektive** kjo vepër penale është konsumohet nëpërmjet veprimeve aktive të kryera prej autorit, të manifestuara në formën e premtimit, propozimit ose dhënies, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që premton ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara. **Nga ana subjektive**, kjo veper penale kryhet me faj në formën e dashjes direkte, pasi autori e parashikon kundërligjshmerinë e veprimeve të tij dhe njëkohësisht dëshiron të vijnë pasojat e veprës. **Subjekt** i kryerjes së kësaj vepre penale janë të përgjithshëm, mjafton të plotësojnë në mënyrë kumulative të dy kushtet për të mbajtur përgjegjësi penale, të kenë mbushur moshën për përgjegjësinë penale dhe të jenë të përgjegjshëm mendërisht.

36. Në rastin konkret nuk rezulton që personi nën hetim të ketë kryer ndonjë veprim që t'u krijojë bindjen punonjësve të policisë që atyre mund t'iu rrezikohej jeta/shëndeti prej tij. Frazën e sipërcituar, personi nën hetim e ka thënë në një moment kur oficerëve të policisë gjyqësore që kishin përpiluar aktet procedurale të arrestimit të shtetasit Maksim Suçi nuk ishin prezent në sallën gjyqësore. Për pasojë nuk konfigurohen elementët të figurës së kësaj vepre penale.

37. Në lidhje me veprën penale nenin 317 të Kodit Penal "***Kanosja e gjyqtarit***", i cili parashikon se: *"Kanosja që i bëhet gjyqtarit apo anëtarëve të trupit gjykues, prokurorit, avokatit ose çdo arbitri të caktuar për një çështje për shkak të veprimtarisë së tyre, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.*

38. **Objekti** i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të përcaktuara nga ligjvënësi për të garantuar ushtrimin e rregullt të veprimtarisë së gjyqtarit, prokurorit, avokatit, etj., me

qëllim ushtrimin e detyrës në mënyrë objektive dhe të paanshme; **Nga ana objektive** (actus rea) kjo vepër penale kryhet me veprime aktive/konkrete, duke përdorur fjalë me natyrë kërcënuese në drejtim të gjyqtarit, prokurorit, etj dhe të jetë objektivisht i aftë të shkaktojë frikë. **Nuk është e nevojshme prova e frikës reale të gjyqtarit**, Prokurorit, por mjafton potenciali objektiv i kanosjes; **Nga ana subjektive** (mens rea) kjo vepër kryhet me dashje direkte pasi autori i parashikon dhe dëshiron pasojat kriminale. Vepra penale "Kanosja e gjyqtarit" e parashikuar në nenin 317 të Kodit Penal ka si element të posaçëm "qëllimin e autorit". Autori duhet të ketë si qëllim të posaçëm që nëpërmjet veprimeve të tij të kanose/intimidojë gjyqtarin, prokurorin, etj. në mënyrë që t'i pengojë ata në ushtrimin e rregullt të veprimtarisë së tyre. **Subjekt** i veprës penale është çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm para ligjit.

39. Në rastin konkret personi nën hetim Ulian Barjami nuk ka konsumuar element të figurës së veprës penale të "*Kanosjes së gjyqtarit*", elementi kyç i cili duhet të analizohet, është fraza që ai ka përdorur gjatë mbrojtjes së personit të arrestuar (Maksim Suçi), në seancën gjyqësore të datës 17.10.2025. Konkretisht, fraza që ai ka thënë *"do merrem personalisht me prokurorin dhe oficerët e policisë gjyqësor*e" është përdorur pas pretendimit që aktet e përpiluara në ngarkim të klientit të tij nga policia gjyqësore/prokurori, përmbanin të dhëna të pavërteta, me argumentin se nga pamjet filmike të tavolinë kanë qenë 6 (gjashtë) persona, ndërkohë që nga ana e prokurorisë është thënë se në tavolinë kishin qenë 14 veta. Pra, nga proces-verbali i seancës gjyqësore dhe deklarimet e personit nën hetim rezulton e qartë që shprehja e përdorur nga ky i fundit, marrja personalisht me oficerët dhe prokurorin ka nënkuptuar ndjekjen e rrugëve ligjore nga ai dhe se qëllimi i tij nuk ka qenë të kanoste prokurorin e çështjes.

40. Sa më sipër, rezulton se fakti nuk përbën veprën penale *"Kanosje e gjyqtarit"* parashikuar nga neni 317 i Kodit Penal.

41. Në lidhje me akuzën ***"Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit"***, parashikohet se: *"Kundërshtimi me dhunë, goditjet dhe vepra të tjera dhune që i bëhen gjyqtarit apo anëtarëve të trupit të çdo arbitri të caktuar për një çështje, për ta penguar në kryerjen e detyrës apo për shkak të saj, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet"*.

42. **Objekti** i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt të organeve gjyqësore, prokurorisë, avokatisë, ekspertëve apo arbitrave të caktuar si dhe personin e mbrojtur posaçërisht në legjislacionin penal ose mosveprimet kriminale. **Nga ana objektive**, krimi kryhet me veprime aktive të kundërligjshme që qëndrojnë në kundërshtimin me dhunë fizike, psikike, (rrahje), goditjet dhe vepra të tjera dhunë që i bëhen gjyqtarit, avokatit, eksperteve, çdo arbitri të caktuar për një çështje për ta penguar në kryerjen e detyrës apo për shkak të saj. **Nga ana subjektive** krimi kryhet me dashje të drejtpërdrejtë dhe me qëllim që gjyqtarët, prokurorët, avokatët, ekspertët apo çdo arbitër i caktuar të pengohet për të kryer detyrën

ose për shkak të detyrës. **Subjekt** është çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm para ligjit.

43. Rezulton se në rastit konkret, nuk konstatohet që personi nën hetim Ulian Barjami të ketë bërë ndonjë veprim dhune ndaj gjyqtarit apo prokurorit të çështjes. Por siç u specifikua dhe më lartë, ai vetëm ka përdorur një gjuhë të papërshtatshme, e cila nuk mund të konsiderohet si "dhunë psikike", por si e tillë ajo mund t'ju nënshtrohet masave administrative për shkelje të solemnitetit të gjykimit apo shkelje etike nga ana e personit nën hetim si Avokat mbrojtës, por kurrsesi nuk mund të konfigurojnë elementët e kësaj vepre apo ndonjë vepre tjetre penale.

44. Në kushtet si më sipër Gjykata vlerëson se arrestimi në flagrancë, regjistrimi i procedimit penal si dhe hetimi i personit nën hetim nuk janë kryer në respektim të drejtë të dispozitave procedurale penale, pasi faktet e pretenduara nuk përbëjnë elementët e veprave penale të sipërcituara apo të ndonjë vepre tjetre penale, por ato maksimalisht mund të trajtoheshin me sanksione administrative nga organet kompetente (Gjykata apo Dhoma Kombëtare e Avokatisë).

45. Në përfundim të arsyetimit sa më sipër, gjykata çmon se, kërkesa e paraqitur nga ana e organit të akuzës, për pushimin e procedimit penal nr.7882/2025, për veprat penale *"Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike", "Shpërdorimi i detyrës" dhe "Kallëzim i rremë"* parashikuar nga nenet 245/1, 248 dhe 305 i Kodit Penal, është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar duke u vendosur pushimi i çështjes pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenet 112, 328/1 shkronjat "a", "b" dhe 329/a të Kodit të Procedurës Penale:

VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës.
2. Pushimin e procedimit penal Nr. 7882, datë 22.10.2025, për veprat penale *të "Kanosje për shkak të detyrës", "Kundërshtim dhe goditja e gjyqtarit"* dhe *"Kanosja e gjyqtarit"*, parashikuar nga nenet 238/3, 316 dhe 317 i K.Penal, ndaj personit nën hetim Ulian Barjami.
3. Në bazë të nenit 389 të Kodit të Procedurës Penale, deklarohet heqja e masës së sigurimit personal *"Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore"*, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar me vendimin nr. 658 Regj. Them., datë 17.10.2025, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ndaj personit nën hetim Ulian Barjami.
4. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, sot më datë 23.09.2026.

SEKRETARE

Silvi XHAKOLLI

GJYQTARE

OLTJONA GOXHA

Shpenzime gjyqësore

Njoftime: 900 lekë

Hetime: 3.000 lekë